



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTRI

Nr. 6397 prot.

Tiranë, më 14.08.2019

URDHËR

Nr. 464, datë 14.08 2019

PËR

**“DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË  
DERRAVE TË SHFAQUR NË BULLGARI, RUMANI, SLLOVAKI, BELGJIKË,  
HUNGARI, SERBI DHE MOLDAVI”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43 i Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, informacionet e marra nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian dhe njoftimet e menjëhershme të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE).

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga shteti i Bullgarisë rajonet përkatësisht (Pleven, Vraca, Ruse, Tragoviste, Dobric, Burgas dhe Silistra), të gjithë territorit të shtetit të Rumanisë, Sllovakisë rajoni përkatësisht (Koscie, Trebiso), Belgjikës rajoni përkatësisht (Luksemburgut dhe Liege), Hungarisë, rajonet përkatësisht (Heves, Nogard, Szabolcs- Szatmar-Bereg, Borsod-Abauj- Zemplen dhe Hajdu-Bihar), Serbisë rajonet përkatësisht ( Beograd, Podunavski-Srbija) dhe Moldavisë rajonet përkatësisht (Cimislia, Cantemir, Nisporeni, Cahul dhe Briceni), për në territorin e Republikës së Shqipërisë e të gjithë kafshëve të llojit derra shtëpiake dhe të egër dhe produkteve të tyre.

